



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1318/2017

Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg. 05/09/17

Data/Datum/Date:



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio

Rasti nr. 575/2016

në lidhje me

*Të drejtën në arsim për personat e privuar nga liria -
mosrespektimi i afatit ligjor për fillimin e procesit mësimor
në Qendrën Korrektuese në Lipjan*

Për: Z. Arsim Bajrami , Ministër
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit

Prishtinë, 5 shtator 2017

I. Qëllimi i raportit

1. Në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit, përmes këtij raporti ka për qëllim të tërheq vërejtjen për një nga të drejtat themelore të njeriut, siç është e drejta në arsim, përkatësisht mundësimi i kësaj të drejte për të miturit në Qendrën Korrektuese në Lipjan (QKL). Në këtë drejtim do të trajtohet problematika e vonesave dhe mangësive të tjera në lidhje me organizimin e procesit mësimor në QKL, dhe në bazë të konstatimeve të arritura do të rekomandohet për institucionet kompetente të Republikës së Kosovës, në veçanti për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Komunën së Lipjanit, që të ndërmarrin masat e duhura që procesi mësimor në QKL të realizohet në mënyrë efikase.
2. Përmes vizitave të rregullta në QKL nga zyrtaret e Institucionit të Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshmë: IAP), si dhe informatat e siguruara nga burime të tjera, Avokati i Popullit në vazhdimësi është informuar për sfidat dhe problemet e zbatimit të procesit mësimor në QKL. Andaj përmes këtij raporti synohet të bëhet një analizë e përbledhur e këtij problemi.
3. Duke u bazuar në problemet aktuale që dalin nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të procesit të mësimit në QKL, shkelja e të drejtës në arsim e të miturve gjatë qëndrimit në qendrën korrektuese dhe pas lirimit të tyre, dhe duke e konsideruar arsimimin si një nga të drejtat themelore për personat e dënuar, Avokati i Popullit ka si qëllim kryesor:
 - të bëj analizën e bazës ligjore për zbatimin e të drejtës në arsim për të miturit në QKL, duke rikujtuar detyrimin e institacioneve kompetente që buron nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës, dhe duke vënë ne pah edhe standartet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare që obligojnë në këtë drejtim.
 - të tërheq vërejtjen mbi problemet kryesore që aktualisht e përcjellin zbatimin e kësaj të drejte për të miturit në QKL. Në veçanti do të trajtohen vonesat e fillimit të vitit shkollor siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi, problemet në lidhje me ndarjen e buxhetit nga MASHT me qëllim të organizimit efikas të procesit mësimor në QKL, koordinim ndërmjet institacioneve kompetente, dhënien e dokumentacionit shkollor pas lirimit nga QKL, etj.
 - që në kuadër autorizimeve kushtetuese dhe ligjore të jap rekomandime konkrete për zbatimin efikas të së drejtës për arsimim të personave të mitur në QKL, përmes organizimit të mësimit brenda kësaj qendre korrektuese ose edhe në shkollat publike jashtë institucionit.

II. Baza juridike

4. Ky rapport me rekomandime për trajtimin e të drejtës në arsim si e drejtë themelore, në lidhje me organizimin e procesit mësimor për të miturit në QKL, bazohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (tutje Kushtetuta), përkatësisht nenin 132, parag.1-3, ku përcaktohet se:

“1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.

3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kérkuara në pajtim me ligj.”

dhe nenit 135, parag.3 ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”

Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nen 18, parag. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjershë, ka edhe këto përgjegjësi:

- “të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre” (pika 1);
- “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë” (pika 2);
- “të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritisë së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (pika 4);
- “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);
- “t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);

dhe nenit 17, parag.2 (2.1), ku në kuadër të Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruuese (MKPT), Avokati i Popullit është i obliguar që: “të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria... ”.

III. Përbledhja e fakteve dhe veprimet fillestare të Institucionit të Avokatit të Popullit

5. Ky raport është iniciuar pas botimit në gazeten Koha Ditore, të shkrimit me titull “Dështon sërish fillimi i mësimit në Qendrën Korrektese në Lipjan”, me 29 shtator 2016.
6. Më 6 tetor 2016, IAP, përkatësisht zyrtarët e MKPT në kuadër të mandatit të tyre për të inspektuar në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria (në pajtim me Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës (OPCAT)), kanë vizituar QKL për t'u informuar në lidhje me vonesat e fillimit të vitit shkollor. Pas takimit me Drejtorin e QKL, janë njoftuar se viti shkollor ka filluar me vonesë në krahasim me shkollat e rregullta dhe se MASHT-i ka angazhuar tetë (8) mësimdhënës në procesin arsimor në QKL.

7. Më 1 nëntor 2016, përfaqësuesi i IAP-it është takuar edhe me zyrtarin për arsim në Komunën e Lipjanit, ku është njoftuar se mësimi ka filluar me vonesë prej një muaji. Zyrtari komunal ka theksuar se në të kaluarën ka pasur një bashkëpunim ndërmjet MASHT-it dhe Drejtori i Komunale të Arsimit në Lipjan, ndërsa tani komuna nuk ka qasje në procesin mësimor në QKL. Gjithashtu lidhur me dokumentacionin shkollor për vijuesit e procesit mësimor në QKL, zyrtari komunal ka pohuar se në të kaluarën ky dokumentacion është lëshuar nga DKA, mirëpo meqenëse tani nuk kanë qasje në këtë proces kjo mund të paraqitet si problem në të ardhmen.
8. Më 1 nëntor 2016, përfaqësuesi i IAP-it, përmes adresës zyrtare ka kërkuar informata nga përgjegjësit e QKL lidhur me rastin. Nga informatat e pranuara me 3 nëntor 2016 nga Koordinatori për punësim dhe programe në QKL, konfirmohet se mësimi në QKL ka filluar më 26 shtator 2016 dhe se mësimin e vijojnë 45 nxënës në klasa të kombinuara.
9. Më 2 nëntor 2016, përfaqësuesi i IAP-it, u takua me z. Alush Istogu, u.d.Sekretar i Përgjithshëm i MASHT-it, i cili ka konfirmuar se për të tejkaluar këtë situatë dhe për të gjetur një zgjidhje për fillimin e viti shkollor në QKL, janë angazhuar mësimdhënësit me kontrata të përkohshme deri sa të nxirret një Udhëzim Administrativ i cili do të përcaktoj kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike për çështjen e arsimit në Qendrat Korrektuese.
10. Më 16 nëntor 2016, përfaqësuesi i IAP-it, u takua me z. Rasim Hasani, drejtor i DKA-së në Lipjan, i cili ka pohuar se disa herë i është drejtuar MASHT-it me shkresa për zgjidhjen e rastit, mirëpo MASHT-i nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për tejkalimin e situatës deri në kohën kur kanë punësuar tetë (8) mësimdhënës për të vazhduar mësimi në QKL, deri më tani procesi i mësimit në QKL është zhvilluar duke pasur një bashkëpunim të mirë ndërinstitucional, ku me procesin e mësimit në QKL ka menaxhuar DKA dhe gjithë dokumentacioni si dhe diplomat për nxënës janë lëshuar nga dy shkolla të autorizuara në komunën e Lipjanit, njëra shkollë e mesme e ulët dhe tjetra shkollë e mesme e lartë. Tani me që kjo nuk është e rregulluar me ligj dhe në mungesë të buxhetit dhe numrit të punëtorëve, DKA e ka të pamundur të mbulojë pagat e mësimdhënësve, dhe derisa DKA nuk menaxhon me procesin mësimor në QKL nuk do të këtë mundësi as të lëshoj diploma apo dokumente të tjera për nxënësit në të ardhmen.
11. Më 18 nëntor 2016, përfaqësuesi i IAP-it, ka pranuar shkresat të cilat DKA i ka dërguar MASHT-it lidhur me procesin mësimor në QKL. Gjithashtu me 18 nëntor 2016, përfaqësuesi i IAP-it ka pranuar edhe shkresat të cilat QKL i ka dërguar MASHT-it, vendimin e datës 23.09.2016 për angazhimin e mësimdhënësve, vendimin nr.294/01B, të datës 22.10.2012 për hapjen e dy paraleleve të ndara në QKL, shkresën e datës 09.09.2016 për numrin e nxënësve, numrin e paraleleve dhe mënyrën e kombinimit të tyre në QKL si dhe informatën për mos lëshimin e dokumentacionit shkollor për nxënësit e liruar nga QKL.
12. Më 21 nëntor 2016, nga përgjegjësit e DKA në Lipjan IAP është njoftuar se Qendra Korrektuese në Lipjan është paralele e ndarë e SHFMU “Ismail Luma” në dhe SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan. Të njëjtën ditë, përfaqësuesi i IAP-it, bisedoi me përgjegjësin e shkollës në QKL dhe u njoftua se mësimdhënësit nuk posedojnë kontrata pune.

13. Më 25 nëntor 2016, përfaqësuesi i IAP-it, kërkoi informata shtesë nga MASHT-i, lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore dhe kontratat e punës për mësimdhënësit e angazhuar. Më 30 nëntor 2016, nga MASHT janë pranuar informatat lidhur me ecurinë e procesit mësimor në QKL.

IV.E drejta në arsim për të miturit e privuar nga liria si e drejtë themelore e tyre – standardet ndërkombëtare dhe legislacioni i Republikës së Kosovës

a) Standardet ndërkombëtare

14. Avokati i Popullit, që në fillim rikujton se arsimimi i të miturve që janë të dënuar dhe qëndrojnë në institucionet korrektuese është një nga detyrimi kryesore të institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës që buron nga Kushtetuta, ligjet në fuqi, dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare. Si i tillë ky detyrim i institucioneve për të realizuar një nga të drejtat themelore të njeriut, siç është ofrimi i mundësisë për arsim për të rinjtë nuk mund të shmanget as për të miturit që qëndrojnë në qendrat korrektuese, si në rastin konkret QKL. Për me tepër, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se kjo e drejtë për të miturit e dënuar duhet të mundësohet në kuadër të QKL ose edhe jashtë institucionit, përkatësisht në shkollat publike të rregullta.
15. Aktet ndërkombëtare në nivel të OKB dhe ato në nivel evropian që rregullojnë të drejtat për personat e dënuar, krijimin e mundësisë për arsim e përcaktojnë si obligim për shtetin dhe në mënyrë të veçantë për të rinjtë që janë të privuar nga liria.
16. Në këtë drejtim, “**Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria**” të miratuara në vitin 1990 (Rregullat),¹ përcaktojnë se: “*Çdo i mitur i moshës së detyrueshme për shkollim ka të drejtë për arsim të përshtatshëm për nevojat dhe aftësitë dhe të përcaktuara për përgatitjen e tij apo të saj për kthim në shoqëri. Kurdo që është e mundur, arsimi i tillë duhet të sigurohet jashtë objekteve të privimit nga liria, në shkollat e bashkësisë dhe, në çdo rast, me arsimtarë të kualifikuar përmes programeve të integruara në sistemin arsimor të vendin ashtu që pas lirimit, të miturit të munden që pa pengesë të vazhdojnë arsimin e tyre...*”(neni 38). Duke përcaktuar të drejtën në arsim si një nga parakushtet themelore të risocializimit për personat e mitur të privuar nga liria, dhe duke shprehur si një objektiv të veçantë sigurimin e arsimimit jashtë institucionit korrektaus. Gjithashtu në këtë dokument përcaktohet se: “*Diplomat apo certifikatat arsimore të dhëna të miturve gjatë kohës kur janë të privuar nga liria, nuk duhet që në asnje mënyrë të bëjë me dije se i mituri ka qenë i institucionalizuar*”.
17. Në të njëjtën frysë janë edhe “**Rregullat Evropiane të Burgut**” që janë adaptuar nga Komiteti i Ministrave të KE në vitin 2006 (RrEB), të cilat i kushtojnë një vëmendje të posaçme të drejtës në arsim, duke përcaktuar se: “*Çdo burg duhet t'u japë të gjithë të burgosurve të drejtën për të marrë pjesë në programe edukative të cilat janë të kuptueshme dhe plotësojnë nevojat individuale duke marrë parasysh aspiratat e tyre.*”(28.1), si dhe përcaktimi se: “*Pjesë kyçë e regjimeve të të burgosurve të dënuar është një program sistematik arsimi, duke përfshirë dhe aftësitë trajnuese, me objektivin e*

¹ Shih <http://www.un.org/documents/ga/res/45/a45r113.htm>.

përmirësimit të nivelistë përgjithshëm të arsimit si dhe qëllimin e të pasurit të një jete të përgjegjshme dhe pa krimë.”

18. Pastaj dispozitat e tjera i jatin një përparësi arsimimit të personave të rinjë që janë të privuar nga liria, duke përcaktuar se: “*Vëmendje e veçantë i kushtohet arsimimit të të burgosurve në moshë të re ...*” (28.4), ndërsa një dispozitë tjetër e sistemuar në pjesën për të drejtat e të miturve që qëndrojnë në institucionet korrektuese, arsimimin e tyre e definon si të drejtë që detyrimisht duhet të mundësohet, ku parashihet se: “*Cdo i burgosur që është i mitur dhe është subjekt i arsimit të detyrueshëm ka akses në arsim*”.
19. Gjithashtu edhe **Rekomandimi Nr. R(89) 12 për arsimin në burg**, i miratuar nga Komiteti i Ministrave i KE-së në vitin 1989, të drejtën në arsim e përcakton si themelore dhe si një nga mënyrat kryesore që lehtësojnë riintegrin e personave të dënuar në shoqëri.²
20. Në lidhje me zbatimin e të drejtës në arsim për personat e mitur që janë në QKL, Avokati i Popullit në mënyrë të veçantë tërheq vërejtjen në lidhje me standarde përcaktuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe protokollet e saj³, si dhe vendimet e GJEDNJ.
21. Në këtë drejtim rëndësi të posaçme ka **Protokolli Nr.1 i KEDNJ**, përkatesisht nen 2 i tij, ku përcaktohet se: “*Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.*” Si e tillë e drejta për arsimim e garantuar me këtë dispozitë vlen edhe për personat e privuar nga liria.
22. Mbi këtë bazë edhe GJEDNJ ka konstatuar se të burgosurit e ndaluar ligjërisht vazhdojnë të gjojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Konventa, me përjashtim të së drejtës për liri. Kështu ata kanë të drejtën e arsimit të garantuar me nenin 2 të Protokollit nr.1. Refuzimi për të regjistruar një të burgosur në një shkollë të burgjeve përbën shkelje të kësaj dispozite (*Velyo Velev kundër Bullgarisë, 27 Maj 2014*). Sigurisht, e drejta në arsim nuk nënkupton detyrimin e shtetit që të organizohen orë mësimi *ad hoc* vetëm për shkak të kërkesave individuale, dhe pamundësia e plotësimit të këtyre kërkesave nuk përbën shkelje të nenit 2 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ (*Epistatu kundër Rumanisë, 24 Shtator 2013*).
23. Nga kjo që u tha me lartë, del se standarde ndërkombëtare, përcaktojnë detyrimin e institucioneve të Republikës së Kosovës që të garantojnë të drejtën për arsim, si një e drejtë themelore edhe për personat e mitur që qëndrojnë në QKL. Për me tepër, Avokati i Popullit rikujton se një obligim i tillë është i përbajtur qartësisht edhe në legjislacionin e brendshëm.

²Shih [http://pjeu.coe.int/documents/3983922/6970334/CMRec+\(89\)+12+on+education+in+prison.pdf/9939f80e-77ee-491d-82f7-83e62566c872](http://pjeu.coe.int/documents/3983922/6970334/CMRec+(89)+12+on+education+in+prison.pdf/9939f80e-77ee-491d-82f7-83e62566c872).

³ Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, KEDNJ zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike (neni 22).

b) Legjislacioni i Republikës së Kosovës

24. E drejta në arsim, si e drejtë themelore e njeriut përcaktohet edhe në legjislacionin e Republikës së Kosovës. Në pajtim me fryshtën dhe tekstin e akteve ndërkombëtare të përmendura me lartë, edhe në legjislacionin e brendshëm, e drejta për arsim garantohet edhe për personat e privuar nga liria, rrjedhimisht edhe për të miturit që qëndrojnë në QKL.
25. Fillimi, e drejta në arsim për shkak të rëndësisë që ka, përcaktohet në Kushtetutë, ku në nenin 47 parashihet se: 1.“*Secili person gjzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë....*”(parag.1) dhe se: “*Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.*” (parag.2).
26. Në pajtim me standarde KEDNJ në lidhje me të drejtën për arsimim dhe vendimet e GJEDNJ që u cituan me lartë, kjo e drejtë e përbajtur në Kushtetutë nuk kufizohet as për personat që sipas ligjit janë privuar nga liria. Avokati i Popullit, thekson se ky standard aq me tepër vlen për rintjtë, përkatësish të miturit që qëndrojnë në QKL. Ky standard i respektimit të të drejtave të njeriut dhe mos kufizimit të tyre edhe në raste e privimit nga liria, gjen mbështetje edhe në nenin 14 të KEDNJ ku parashihet se : “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnje dallim të bazuar në shkaqe të tillë si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”
27. Andaj, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se edhe vendimet e institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti nga MASHT duhet të jenë në **interesin me të mirë të personave të mitur**, edhe kur bëhet fjalë për organizimin e procesit mësimor në QKL. Ky parim përcaktohet edhe në Kushtetutë, përkatësish nenin 50, parag.4 ku parashihet se: “*Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.*” Gjithashtu, i njëjti përcaktim përbahet edhe në **Konventën për të Drejtat e Fëmijës**,⁴ ku në nenin 3 parag.1 të saj përcaktohet se :“*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesit më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*”
28. Për me tepër, e drejta në arsim për personat e privuar nga liria, aq me tepër për të miturit që qëndrojnë në qendrat korrektuese siç është QKL garantohet edhe me disa nga ligjet e tjera që rregullojnë këtë të drejtë.
29. Kështu, në **Ligin për Arsimin Parauniversitar**,⁵ në nenin 5, parag.15 për këtë qëllim përcaktohen detyrat e MASHT, si në vijim: “*Ministria në bashkëpunim me ministritë relevante, ndërmerr masa të veçanta për arsimin e individëve në burgje ose në*

⁴ Konventë është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989. Kjo konventë gjithashtu zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, njësoj si KEDNJ (neni 22 i Kushtetutës).

⁵ Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 29 gusht 2011.

institucionet për shkelësit e mitur të ligjit, si dhe për ata të mbyllur në institucione psikiatrike, ose për ata që i nënshtronen hospitalizimit afatgjatë, janë në përkujdesje sociale në strehimore dhe për ata që janë liruar nga institucionet ose nga spitalet dhe vazhdojnë procesin arsimor.” Ndërsa në vazhdim, në parag.16, parashihet se: “*Ministria nxjerrë akte nënligjore në çdo fushë të përgjegjësive të saj në bazë të këtij ligji ose cilidoligj tjetër në fuqi.*” Ky përcaktim shpreh detyrimin ligjor që ka MASHT për të nxjerrë akte nënligjore edhe në lidhje me definimin e kushteve dhe kritereve që lidhen me organizimin e procesit mësimor në QKL. Ky aspekt do të trajtohet edhe në vijim të raportit.

30. Pastaj **Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale(LESP)⁶**, në nenin 83, parag.1, përcakton se: “*Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin...*” dhe sipas parag.3 “*përgjegjëse për arsimin fillor dhe të mesëm në institucionin korrektues është Ministria kompetente për arsim*” (në këtë rast MASHT), ndërsa Shërbimi Korrektues i Kosovës është përgjegjës për caktimin e lokacionit dhe infrastrukturës ku do të zhvillohet mësimi (parag.2). Në parag.7 përcaktohet gjithashtu se: “*Me akt nënligjor, të cilin e nxjerrë Ministri për Arsim me pëlgimin e Ministrat të Drejtësisë rregullohet arsimimi i pësonave të dënuar.*” Pastaj, në nenin 86 të LESP përcaktohet se në: “*Dokumentin e lëshuar pas përfundimit të aftësimit profesional, ose kurseve arsimore nuk shënohet se kurset janë kryer gjatë qëndrimit të personit të dënuar në institucionin korrektues*”, duke respektuar kështu parimin se diplomat dhe certifikatat për arsimim në qendrat korrektuese nuk duhet të dallojnë nga ato që fitohen në shkollat jashtë.

31. Për me tepër, **Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KDM)⁷** në nenin 119 përcakton se: “*Nëse nuk ka orë mësimore për lëndë të caktuara ose nuk ka nivel arsimor në institucionin edukativ korrektues, i mituri lejohet të vijojë mësimin jashtë institucionit edukativ korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative dhe vendimi arsyetohet me përparimet e mëparshme të të miturit në shkollim.*” Kjo dispozitë ndërton bazën që në rastet kur procesi arsimor nuk mund të zhvillohet në qendrën korrektuese, të miturit të vijojnë mësimin në shkollat jashtë, një alternativë që Avokati i Popullit e konsideron të nevojshme të zbatohet edhe për të miturit që ndodhen në QKL, kur nuk arrihet të organizohet me kohë dhe në mënyrë cilësore procesi mësimor brenda qendrës korrektuese.

V. Problemët në organizmit e procesit mësimor në QKL

a) Vonesat në fillimin e procesit mësimor

32. Në lidhje me afatin e fillimit të mësimit në QKL, duke u bazuar në nenin 3, parag.1 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.14/2016, për kalendarin e vitit shkollor 2016/2017, ku përcaktohet se “*Gjysmëvjetori i parë fillon më 1 shtator 2016 dhe mbaron më 23 dhjetor 2016.*”, IAP vëren se gjysmëvjetori i parë ka filluar me vonesë prej afersisht 1 muaji, përkatësisht më 26 shtator 2016 (data e fillimit të mësimit në QKL).

⁶ Ligji Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 29 korrik 2013.

⁷ KODI Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të mitur është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 10 korrik 2010.

33. Nga tē dhēnat e siguruara nga hulumtimi i realizuar nga zyrtarët e IAP, vërehet se vonesat nē fillimin e procesit mësimor nē QKL kanë qenë tē vazhdueshme edhe nē vitet paraprake. Këto vonesa ka ndodhur pér shkak tē mos koordinimit me kohë ndërmjet institucioneve kompetente, përkatisht DKA-së nē Lipjan dhe MASHT, mungesa e mësimdhënësve, mungesa e ndarjes së mjeteve buxhetore (granteve specifike) nga MASHT, etj.
34. Në këtë drejtim, vërehet se Kryetari i Komunës së Lipjanit ka shprehur shqetësimet lidhur me qarkoren buxhetore pér vitin 2016, dhe ka paralajmëruar z. Arsim Bajrami, Ministër i MASHT-it, z. Avdullah Hoti, Ministër i Ministrisë pér Ekonomi dhe Financa dhe z. Hajredin Kuqi, Ministër i Ministrisë së Drejtësisë, se nē rast se granti specifik i arsimit mbetet sipas projekzionit buxhetor 2016, Komuna e Lipjanit nuk do tē mund tē vazhdoj organizimin e mësimit nē QKL (*Shkresa Nr. 1-400-25795, dt. 25 maj 2015*).
35. Po ashtu, nga shkresa e z. Alush Istogu, Drejtor i Departamentit pér Politika të Arsimit Parauniversitar nē MASHT, drejtar Sekretarit të Përherëshëm nē Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorit të DKA-së nē Lipjan, vërehet se edhe nē tē kaluarën ka pasur vonesa pér fillimin e vitit shkollor nē QKL, ku pér vitin 2015 konstatohet se ende nuk ka filluar procesi mësimor (*shkresa e datës 20 tetor 2015*) dhe se kjo ka ndodhë pér shkak tē pengesave financiare-buxhetore që kanë QKL dhe Komuna e Lipjanit (*Shkresa me Nr. të Referencës 3857, të datës 20 tetor 2015*). Gjithashtu, një nga konstatimet nē këtë shkresë është se : “*Shkresat e dërguara nga QK-Lipjan, DKA-e Lipjanit nē Ministritë relevante MASHT dhe MD, i konsiderojmë si kërkesa tē arsyeshme dhe nevojë e domosdoshme nē zgjidhjen e problemit, me qëllim që tē rinjve tē Qendrës Korrektuese t'u ofrohet mundësia e shkollimit edhe nē këto rrethana*”.
36. Përkundër këtyre kërkeseve dhe konstatimeve të vitit 2015, siç u theksua me lartë, edhe nē vitin 2016 kanë vazduar problemet e organizimit të procesit mësimor sipas afatit të përcaktuar. Ky problem vihet nē pah edhe nga një shkresë e vitit 2016 që Drejtori i QKL i drejtohet Sekretarëve të MASHT dhe Ministrisë së Drejtësisë, tē cilët njoftohen se ka probleme nē lidhje me fillimin e mësimit pér vitin shkollor 2016/2017 (*Shkresa Nr. 548, e datës 6 shtator 2016*).
37. Nga shkresat e pranuara nga IAP vërehet se DKA nē Lipjan ka bërë kërkësë nē MASHT edhe pér rritjen e numrit të mësimdhënësve pér t'u angazhuar nē procesin mësimor nē QKL (përtej grantit specifik tē arsimit) si qendër specifike, gjithashtu është kërkuar nga Ministri i MASHT nxjerrja e akteve nënligjore pér menaxhimin e paraleles së ndarë nē QKL.
- b) Problemët nē lidhje me lëshimin e dokumentacionit shkollor**
38. Një nga sfidat tjera me tē cilën përballen tē miturit që kanë vijuar mësimin nē QKL, ka tē bëjë me problemin e mos pajisjes me dokumentacion shkollor, certifikata apo diplomë pas daljes nga QKL.
39. Avokati i Popullit rikujton se kjo është një e drejtë ligjore që u takon personave të privuar nga liria, siç është trajtuar edhe nē këtë raport, që diplomat dhe certifikatat duhet tē jenë tē barabarta me ato që vlejnë edhe pér nxënësit që vijojnë mësimin nē shkollat e rregullta.

IAP është informuar nga komunikimi ndërmjet QKL dhe MASHT-it, se “*asnjë nxënës që ka ndjekur mësimet vitin e kaluar nuk është pajisur me dokumente. Tani një numër nga ata nxënës (të mitur) janë liruar nga Qendra Korrektuese dhe të njëjtë tanit po kërkojnë dokumente nga shkolla jonë për të vazhduar shkollimin në vendlindjet e tyre, por ne nuk po kemi mundësi që t'i pajisim me këto për arsyen se SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan nuk lëshon dokumente për këta nxënës.*” Kjo është arsyetuar me faktin se tanit DKA dhe shkollat nuk kanë qasje në organizimin e procesit mësimor në QKL dhe për pasojë nuk kanë mundësi që për nxënësit të lëshojnë dokumentacion.

40. Për këtë aspekt, IAP është informuar edhe nga palët që janë dëmtuar për shkak se nuk janë pajisur me dokumentacion shkollor pas daljes nga QKL. *Kështu sipas informatës të pranuar më 18 nëntor 2016 nga QKL, i mituri L.J. është liruar nga QKL më 30 qershori 2016, dhe ka këruar certifikatën e notave në mënyrë që t'i mundësohet hyrja në provimin e maturës në afatin e gushtit në shkollën ku ka vijuar mësimin, për shkak të mos lëshimit të dokumentacionit pas lirimit nga QKL, nxënësi në fjalë nuk ka mundur t'i nënshtronhet provimit të maturës shtetërore.*
41. Në lidhje me këtë rast, dhe raste të tjera që janë liruar nga QKL e nuk janë pajisur me dokumentacion, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin dhe konstaton se kjo është shkelje e të drejtës në arsim. Për me tepër, derisa orët e humbura për shkak të vonesës për fillimin e mësimit në QKL mund të zëvendësohen, shkelja ndaj të miturit L.J. ka pasoja edhe me të mëdha, derisa ka humbur mundësinë që ti nënshtronhet provimit të maturës shtetërore, provim që organizohet vetëm pas përfundimit të vittit shkollor.
42. Gjithashtu, IAP më 18 nëntor 2016, ka pranuar ankesën nga babai i të miturit F.L⁸, *i cili poohon se djali i tij është liruar nga QKL më 11 nëntor 2016, dhe për shkak se nuk është pajisur me dokumentacion shkollor nuk po mund të vazhdoj mësimin në shkollën e mesme të lartë.*
43. Një nga problemet e tjera që lidhet me pajisjen me dokumentacion shkollor, dhe sidomos mundësinë e vijimit të mësimit në shkollat jashtë pas daljes nga QKL ka të bëjë edhe me ndërrimin e profileve, ku sipas Udhëzimit Administrativ nr.16/2011, të datës 30.12.2011, përcaktohet se : *“Kërkësen për të kaluar prej një profili arsimor në tjetrin, nxënësi e bën në mbarim të gjysmëvjetorit të parë të vittit shkollor, (05-20 dhjetor), ose para fillimit të vittit të ardhshëm shkollor, (15-20 gusht)”* (neni 4, parag.1). Kjo paraqitet si problem sepse numri i nxënësve në QKL nuk mund të planifikohet, derisa nuk mund të dihet se kur dhe prej cilit profil arsimor do të vijnë të miturit në QKL, andaj rrjedhimisht nuk mund të zbatohen as afatet e përcaktuara në udhëzimin në fjalë. Për këtë arsyen, Avokati i Popullit propozon që ky udhëzim të ndryshohet.

c) Problemet në lidhje me angazhimin e mësimdhënësve nga MASHT

44. Me qëllim të tejkalimit të gjendjes së krijuar, MASHT-i ka nxjerrë vendimin Nr.2-9540 Më 23 shtator 2016, për angazhimin e kuadrit arsimor në QKL për vitin shkollor 2016/17, sipas të cilit angazhohen tetë (8) mësimdhënës, ndërsa në parag.2 të vendimit përcaktohet se: *“Të lartpërmendurit do te lidhin kontrata pune sipas Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe*

⁸ Rasti A.nr.813/2016.

Udhëzimit Administrativ nr. 10/2015 të dt.01.09.2015 për kontratën e punës për mësimdhënës të arsimit parauniversitar.”

45. Duke ju referuar dispozitave të Ligjtit të Punës, përkatësisht nenit 10 parag.1 del se: “*Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari....*”, ndërsa sipas Udhëzimit Administrativ nr.10/2015, nenit 1, përcaktohet se “*Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është krijimi i bazës juridike për Kontratën e Punës për Mësimdhënës të Arsimit Parauniversitar si dhe përcaktimi i kritereve për lidhjen e kontratës ndërmjet Drejtorive Komunale për Arsim, si punëdhënës, dhe mësimdhënësit, si punëmarrës.*” Për me tepër edhe sipas nenit 5, shprehimisht thuhet se “*Drejtoritë Komunale për Arsim përgatisin dhe lidhin kontratatat përkatëse për të gjithë mësimdhënësit e angazhuar në procesin edukativ arsimor*”. Nga këto dispozita, Avokati i Popullit vëren një kolizion të dy akteve, sepse sipas këtij Udhëzimi “*kontrata e punës lidhet ndërmjet DKA si punëdhënës dhe mësimdhënësit si punëmarrës*”, ndërsa në rastin konkret, mësimdhënësit angazhohen nga MASHT-i. Sipas informatës së pranuar nga MASHT më 30 nëntor 2016, kontratat e punës për mësimdhënësit e angazhuar janë nënshkruar më 23 nëntor 2016.
46. Në lidhje me organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në QKL, është me rëndësi Vendimi i Ministrit të MASHT Nr.294/01B i datës më 22 tetor 2012, sipas të cilit Komunës së Lipjanit i lejohet hapja e 2 (dy) paraleleve të ndara në QKL, një paralele e ndarë në kuadër të SHFMU “Ismail Luma” për nivelin 1 dhe 2, dhe një paralele e ndarë në kuadër të SHMLP “Adem Gllavica” në Lipjan. Nga informatat e pranuar nga IAP, ky vendim është akoma në fuqi.⁹ Andaj, sipas këtij vendimi mund të konstatohet se me paralelet e ndara të SHFMU “Ismail Luma” dhe SHMLP “Adem Gllavica” në Lipjan, duhet të menaxhoj DKA në komunën e Lipjanit si punëdhënës. Andaj mbi këtë bazë, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme që MASHT dhe Komuna e Lipjanit të bashkëpunojnë në kuptim të zbatimit të kompetencave të tyre në lidhje me menaxhimin efikas të procesit mësimor në QKL, sidomos përfshirjes në këtë proces të DKA-së në Lipjan.
47. Në fund, në lidhje me angazhimin e mësimdhënësve me kontrata të përkohshme nga MASHT-i, Avokati i Popullit vlereson se kjo paraqet një masë te veçantë në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në QKL dhe ne qendrat e tjera korrektuese, mirëpo detyrë e MASHT është që të nxjerrë akte nënligjore me qëllim të rregullimit të kësaj çështje dhe qartësimit të përgjegjësive institucionale në lidhje me organizimin e procesit mësimor për personat e privuar nga liria. Në këtë drejtim është vërejt se ka pas vonesa nga ana e MASHT në përbushjen e këtyre obligimeve ligjore.

Konstatimet kryesore të Avokatit të Popullit

48. Në këtë raport është trajtuar në nga të drejtat themelore të njeriut, e drejta në arsim, nga aspekti i gjëzimit të kësaj të drejte nga personat e privuar nga liria. Me konkretisht, rapporti është fokusuar në problemet e organizimit të procesit mësimor në QKL për të miturit që janë të privuar nga liria dhe qëndrojnë në këtë qendër korrektuese.

⁹ *Informata e pranuar nga MASHT-i, Nr.3-5069, data 30.11.2016.*

49. Nga analiza e të **drejtës në arsim** në raport me aktet ndërkombëtare (në veçanti me KEDNJ dhe standardin e ndërtuar nga GJEDNJ), Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit konstaton se kjo e drejtë garantohet edhe për personat e privuar nga liria. Aq me tepër, mundësimi i kësaj të drejte është obligim kushtetues dhe ligjor për institucionet e Republikës së Kosovës, kur bëhet fjalë për personat e mitur që janë të privuar nga liria, siç është rasti me të miturit që qëndrojnë në QKL.
50. Në lidhje me organizimin e procesit mësimor për të miturit në QKL, Avokati i Popullit konstaton se:
- Në vazhdimësi procesi mësimor ka filluar me vonesë. Në vitin shkollor 2016/2017, mësimi ka filluar me 26 shtator 2016, afërsisht 1 muaj me vonesë.
 - Problem tjetër është edhe mungesa e lëshimit të dokumentacionit për nxënësit (të miturit), përkatësisht certifikatave dhe diplomave pas lirimt nga QKL. Për këto arsy, disa prej të miturve që janë liruar nga QKL u është mohuar e drejta e vijimit të mësimit në shkollat jashtë apo edhe nënshtimi në provimin shtetëror të maturës. Mbi këto fakte, Avokati i Popullit konstaton se kjo përbën shkelje të të drejtës në arsim.
 - Këto vonesa në fillimin e procesit mësimor dhe mohimi i të drejtës për vijimin e mësimit dhe përfundimin e shkollimit pas daljes nga QKL (**rastet e të miturve L.J dhe F.L.**), janë në kundërshtim me Kushtetutën (*nenin 47, parag.2*), KEDNJ (*nenit 2 të Protokollit Nr.1*) dhe standartet e ndërtuara nga GJEDNJ, etj.
 - Në lidhje me fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në QKL, ka munguar koordinimi i duhur midis institucioneve përgjegjëse, në veçanti MASHT-it dhe Komunës së Lipjanit.
 - MASHT ka dështuar që të kryej në kohë obligimet ligjore në lidhje me fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor për të miturit në QKL. Në veçanti sa i përket nxjerrjes së akteve nënligjore për këtë qëllim, përcaktimin e qartë të kompetencave në raport me DKA në Lipjan, ndarjen e mjaftueshëm të buxhetit, sigurimin e numrit të mjaftueshëm dhe me kohë të mësimdhënësve.
 - Si përfundim, Avokati i Popullit e konsideron të domosdoshme që MASHT dhe institucionet e tjera përgjegjëse të ndërmarrin të gjitha veprimet me kohë, në pajtim me obligimet ligjore dhe kushtetuese, që këto praktika të mos përsëriten në të ardhmen, dhe të garantohet e drejta në arsim për personat e mitur në QKL dhe institucionet e tjera ku mbahet personat e privuar nga liria.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të analizës së rastit dhe konstatimeve të arritura, në pajtim me nenin 135, *parag.3* të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 16, *parag.4* të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon :


- **MASHT**, që në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të ndërmerren masat e nevojshme:

- që të nxjerr aktet nënligjore që përcaktohen me ligj në lidhje me organizimin e procesit mësimor për personat e privuar nga liria, përfshirë edhe të miturit që qëndrojnë në QKL duke adresuar nevojat e tyre. Në këtë kuadër është e nevojshme të ndryshohet edhe *parag.1 i nenit 4* të *Udhëzimit Administrativ nr.16/2011, të datës 30.12.2011*, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për kërkeshat për ndërrimin e profileve arsimore për nxënësit në QKL edhe jashtë afateve që aktualisht janë përcaktuar në këtë udhëzim.
- Me akte nënligjore duhet të adresohen qartësisht përgjegjësitet që i takojnë MASHT-it dhe komunave, në këtë rast Komunës së Lipjanit për mbarëvajtjen e mësimit në QKL.
- Që me kohë dhe sipas nevojave të ndaj buxhetin në lidhje me organizimin e procesit mësimor në QKL dhe qendrat e tjera korrektuese. Në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit si dhe ministritë relevante të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për angazhimin e mësimdhënësve në QKL.

- **Komunën e Lipjanit, që:**

- Duke u bazuar edhe në Vendimin e Ministrit të MASHT Nr.294/01B të datës më 22 tetor 2012, dhe në bashkëpunim me MASHT-in, pa vonesa të mëtejme të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që të miturit të pajisen me dokumentacion shkollor me rastin e lirimt nga QKL.

Në pajtim me nenin 132, *parag.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës* (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeshave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj.*”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekondit, kërkessë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*”), mirësish me lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nnderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

Kopje :

- Zyrës për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Znj. Dhurata Hoxha, Ministre
Ministria e Drejtësisë